



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

*Duke u mbështetur ne nenin 40.2 nën (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 dhe nenit 2, nenit 3 të Rregullores Nr. 01-06-8132/2020 për ndarjen e bursave për Studentët e Komunës së Klinës, me kërkesën nr. 01-451-14642 e datës: 03.05.2023 e parashtruar nga drejtoria e arsimit Klinë si dhe me Rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 10.05.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të mbajtur me datën 26.05.2023, mori këtë:*

## V E N D I M

*Për*

*Ndarjen e bursave për studentët për vitin akademik  
2022-2023*

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për ndarjen e 60 ( gjashtëdhjetë ) bursave për studentët e dalluar të Komunës së Klinës në shumë prej 50 € në muaj për një student, për vitin akademik 2022-2023.
2. Ndarja e bursave behët nga Komisioni komunal për ndarjen e bursave i themeluar nga Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në rregulloren për ndarjen e bursave për student.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtoria e Arsimit, Zyra Ligjore, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-18046 /23  
Klinw me 31.05 /23



Kryesuesi i Seancës  
Valmir Bacaj